

VENDIM
Nr. 765, datë 20.12.2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 189, DATË 15.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME USHQIM TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË STUDENTËVE DHE KURSANTËVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË POLICISË SË SHTETIT, SI DHE TË SHTETASVE TË NDALUAR OSE TË ARRESTUAR, DERI NË SQARIMIN E POZITËS SË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 189, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar ose të arrestuar, deri në sqarimin e pozitës së tyre”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në fillim të pikës 1, fjalët “Trajtohen me ushqim, pa pagesë, strukturat e Policisë së Shtetit, si më poshtë:” zëvendësohen me “Të drejtën e përfitimit të trajtimit me ushqim e gëzojnë strukturat, si më poshtë:”;

b) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Punonjësit e Policisë së Shtetit:

i. me një vakt “drekë”, kur kohëzgjatja e punës është 8 (tetë) orë;
ii. me tri vakte, kur punonjësi është i angazhuar në gatishmëri, në shërbime për ruajtjen e rendit, sigurimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, për përballimin e situatave emergjente dhe të fatkeqësive natyrore, aktivitete të ndryshme apo tubime, kur kohëzgjatja e punës është më shumë se koha normale e punës prej 8 (tetë) orësh.”;

c) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Punonjësit e Qendrës së Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare, në Akademinë e Sigurisë, trajtohen me tri vakte ushqim pa pagesë.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Përfitimi i trajtimit me ushqim bëhet i gatuar në mensa ose, kur nuk është e mundur, jepet në formën e një kompensimi financiar, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 4, të këtij vendimi.”.

3. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Shuma e kompensimit financiar transferohet në një llogari të posaçme bankare, të hapur nga punonjësi, në bankat e nivelit të dytë, e cila ka si qëllim përdorimin vetëm për trajtimin me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, sipas rregullave të kësaj pike. Llogaria e posaçme bankare mund të përdoret vetëm nëpërmjet një karte të posaçme që lejon kryerjen e transaksioneve bankare vetëm në njësi tregtare ushqimore ose rrjete të tyre. Rregullat dhe procedurat për përdorimin e kartës së posaçme në njësitë tregtare ushqimore ose rrjetet e tyre përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”.

4. Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1 dhe 4/2, me këtë përmbajtje:

“4/1 Masa e vlerës për kompensimin në lekë për çdo normë të trajtimit me ushqim është për:

- a) normën ditore të ushqimit me një vakt “drekë”, në vlerën 450 (katërqind e pesëdhjetë) lekë;
- b) normën ditore të ushqimit me tri vakte, në vlerën 840 (tetëqind e dyzet) lekë.

4/2 Vlerat e kompensimit në lekë të normave ditore të ushqimit, të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4/1, të këtij vendimi, rriten me të njëjtën masë, si dhe masa e indeksimit të pagave të të punësuarve në institucionet e administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.”.

5. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1 Përfshihet për vitin 2023, shuma e kompensimit financiar, të përcaktuar në pikën 4/1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë bankare të pagës për të gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, që përfitojnë kompensimin financiar.”.

II. Efekti financiar për vitin 2023 mbulohet nga buxheti i Ministrisë së Brendshme.

III. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama